



KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL VI/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 6 (gjashtë) për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 30.06.2023
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci
Z.Selman Kolgeci
Z. Flamur Bytyçi
Z. Urim Suka
Z. Kushtrim Kuçi
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj.Doruntina Zenelaj
Z.Alban Berisha
Z. Bexhet Kuçi
Z. Reshat Selimaj
Z. Lirim Qatani
Z. Aziz Bytyqi
Znj.Sanie Kuçi-
Rexhepaj
Znj.Fidaije Kukaj

Znj. Afërdita Morina
Z. Vullnet Luzhnica
Z. Xhevshet Gashi
Z.Edon Sadikaj
Znj.Saranda
Bajraktari
Znj.Mimoza Bajraktari
Znj.Festë Kabashi
Z.Dardan Berisha
Z.Bajram Basha
Znj.Mevlude Kabashi
Znj.Sheqerije Zyrapi
Znj.Laureta Tafaj
Z.Liridon Fandaj
Z.Qëndrim Elshani
Z.Herolind Limaj
Znj.Jehona Rrafshi

Të pranishëm të tjerë

Kryetari i Komunës
Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj.Habibe Bytyqi
Z.Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2024-2026;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përcaktimin e vlerës së bonos banimit;
4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e Rregullores 01-Nr-209;
5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Ekonomike” në Duhël;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Industriale” në Shirokë;
7. Shqyrtimi i kërkesës së Komisionit Komunal të Aksionarëve i NPL “Stacioni i Autobusave” në Suharekë për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave dhe raporti i Komisionit Komunal të Aksionarëve i NPL “Stacioni i Autobusave” në Suharekë;
8. Pyetje dhe përgjigje;

Reshat Selimaj - kërkoj që të tërhiqet pika 7 për shkak se tani komisioni është funksional.Nga agjensioni për parandalimin e konfliktit të interesit është konstatu që procedura nuk ka pas konflikt interesi andaj nuk ka nevojë që të jetë në rend dite.

Kryesuesi - e hedh në votim që pika e 7-të të tërhiqet nga rendi i ditës.

16 për, 10 kundër
Tërhiqet pika e 7-të nga rendi i ditës

Selman Kolgeci - te kjo pikë mendoj që diçka nuk shkon te raporti i tyre. Komisioni Komunal i Aksionarëve ka thënë që ndihet i shantazhuar dhe nën presion.

Kryesuesi - unë e hodha në votim dhe personalisht isha kundër.Mund ta diskutosh te pyetje dhe përgjigje.

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës pa pikën 7.

18 për, 11 apstenime
Miratohet rendi i ditës

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e kornizës afatmesme buxhetore për Komunën e Suharekës për vitin 2024-2026;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - KAB është një ndër dokumentet më të rëndësishme që ky Kuvend miraron dhe si i tillë vendos drejtimet se si do të shpenzohen paratë publike për tri vitete e ardhshme. Unë e kam lexuar me vëmendje dokumentin dhe do të përpiqem ti jap mendimet e mia që ky dokument të jetë sa ma profesional dhe ti shërbej të gjithë qytetaraëve. Qëllimi im nuk është thjesht të bëj opozitën por qëllimi im është të marrim vendime të përbashkëta që janë në të mirë të qytetarëve dhe jo qeveritarëve. Më lejoni të theksoj disa çështje që dëshmon që ky dokument nuk është i përgaditur sipas nevojave të qytetarëve. Në kornizën që ju keni planifiku figurojnë rrugët: Dy Martirët, vazhdimi i rrugës Seferi dhe rrugës Veterani. Rruga “Dy Martirët”, është fjala për rrugën “Boka” që ky pushtet ka bërë tri kontrata për tri vite dhe nuk e ka shtrur. Tash këtë rrugë e ka sjell me emrin “Dy Martirët”. Buxheti që është planifiku për këto tri rrugë, nuk mjafton as vetëm për këtë rrugë. Çka do të ndodh me rrugën “Hajriz Xhema”, “8 Vëllezërit”, “Esat Qarri” që ju i keni pas në kontrata më herët dhe tash askund nuk figurojnë dhe nuk janë të shtruara? Çka do të ndodh me rrugën “Bashkimi” që është kërkesë e madhe e qytetarëve dhe nuk është fare në planifikim dhe nuk ka qenë. Është tepër e çuditshme dhe e pa kuptueshme planifikimi që keni bërë në këtë kornizë për projektin e varrezave të qytetit në Biraq. Për këtë projekt në këtë kornizë, për tri vite ju i keni planifikuar 1.2 milion euro. Kjo për mua është e pakuptueshme dhe e papranueshme. Unë kam mbi një vit që vazhdoj të kërkoj buxhet simbolik për funksionimin e varrezave në Bllacë dhe ju as që mendoni për këtë. Fakti që ju keni bërë një ndarje prej 1.2 milion euro për varrezat e qytetit në Biraq, unë mendoj që është alarm për secilin prej nesh mos me votu këtë kornizë. Te Kolektori në rrugën “Skënderbeu” në vitin 2021 ju i keni shpenzu 400.000€ në emër të këtij projekti por punët s’kanë fillu fare. Për vitin 2023 janë planifiku 370.000€ për Kolektorin në rrugën “Skënderbeu” por deri tani ende s’keni fillu punën në këtë projekt, ndërsa në vitin 2024 janë planifiku vetëm 50.000€ , në vitin 2025 350.000€ dhe në vitin 2026 400.000€. Është planifikim që është alarm për mos me votu ne. Për Budakovë janë planifiku në kornizën 2024-2026 rruga “Mehmet Xhafa” dhe “Bjeshkët e Budakovës” por këto rrugë janë të planifikuara edhe në vitin 2023 dhe duhet të shtrohen këtë vit. Pse janë të planifikuara edhe në kornizë? Situata e njejtë është edhe në fshatin Luzhnicë në rrugën “Afrim Buqa”. Shembuj të tillë janë plot. Çka do të bëhet me gjithë ato probleme me kanalizime në fshatin Bllacë sepse nuk pashë diçka të planifikuar për kanalizime në fshatin Bllacë? Çka do të bëhet me ujësjellësin në Bllacë? E dime që janë të ndara 200.000€ për tri fshatrat por ende s’ka fillu asnjë aktivitet dhe në kornizë nuk keni planifiku asgjë për vitet e ardhshme edhe pse keni premtu për ujë. Çka do të bëhet për funksionalizimin e hapësirave për varreza në Bllacë? Çka do të bëhet me ndriçimin publik që është më shumë se 50% jasht funksionit? Çka do të bëhet me shtratin e lumit në Bllacë e disa ura që janë atje? Në këtë kornizë ju keni planifikuar ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza, në Dubravë 330.000€ për tri vite dhe në Sllapuzhan 195.000€ për tri vite. Është e çuditshme sepse për projektin e njejtë dikun dalin 330.000, dikun 198.000. Nuk e di a e keni infomatën për fshatin Bllacë, për problemet që kanë me ujrën e zeza dhe nuk e di pse nuk e keni parapa një buxhet për një impiantë për ujëra të zeza në fshatin Bllacë. Ndërtimi i zonave infrastrukturore smart tek vendkalimet për këmbësor, ju keni planifikuar 80.000€ në këtë kornizë mirëpo për këtë projekt për vitin 2023 i keni planifiku 150.000€ por gjithëashtu për këtë projekt në vitin 2021 i keni shpenzu 250.000 ndërsa e vërteta është që këto shenja që ju po i vendosni, po bien poshtë sepse kualiteti është zero. Për ndërtimin e aneksit të shkollës “Besim Ndreca” në Maqitevë ju keni planifikuar 120.000€ për vitin 2023 ndërsa në këtë kornizë ju keni planifikuar 350.000€ të tjera. Ky aneks a do të ndërtohet këtë vit? Mendoj që është shumë për një aneks 450.000€. Në KAB për vitin 2022-2024 ju keni planifikuar 1.300.000€ për ndërtimin e objektit të Komunës ndërsa në miratimin e buxhetit 2023 ju keni planifiku 50.000€ ndërsa në kornizën 2023-2025 keni planifiku 250.000€ kurse në këtë kornizë që e keni sjell keni planifiku 10.000€. A keni hek dorë nga ndërtimi i objektit të Komunës? Të dashur kuvendar, këto që i thash nuk janë thjesht zë opozitar por janë fakte konkrete që ju i keni në atë dokument. Ju ftoj që të votoni kundër me idenë që të ripunohet e të silltet një dokument profesional dhe që është në harmoni me kërkesat e qytetarëve. Ne do ta votojmë kundër sepse është një keq planifikim i madh.

Kryesuesi - seancën e fundit keni kërku me zbatu rregulloren e Kuvendit. E drejta e replikës për të njejtën pikë është vetëm një here dhe jo më shumë se dy min. dhe unë kërkoj nga ju që ta zbatojmë rregulloren.

Selman Kolgeci - kam pyetje për Kryetarin dhe ata të cilët e kanë punuar hartimin e projekt-buxhetor. Mbi cilin kriter i keni nda mjetet për rrugët të cilat janë pjesë e projekcionit buxhetor kur dihet që nuk keni projekte prej asnjërës prej rrugëve? Cila ka qenë formula që i keni kalkuluar këto mjete për rrugët dhe objektet tjera të investimeve kapitale? Për fshatin Vraniq e kemi diskutuar disa here nevojën e investimit në parcellën e ndarë nga Kuvendi Komunal për varrezat e fshatit Vraniq dhe po e shoh që nuk është parapa në këtë kornizë asnjë euro për këtë çështje. Ju jeni të informuar mjaft mirë për nevojën që ka fshati Vraniq për varrezat. Nuk kërkon investim të madh, duhet pastrim nga shkurret dhe rrethim i rrethojave përgjatë perimetrit të parcellës. Investim i nevojshëm është edhe në kaptazha të ujit të pijes. Pse nuk keni planifikuar mjete për sanimin e ujëmbledhësve? Po ashtu nuk keni planifikuar asnjë euro për ndërtimin e këndit të lojërave për fshatin Vraniq. Çfarë obligimi ju ka fshati Vraniq që nuk po jeni të gatshëm që përpos projekteve tjera të investoni edhe në këto dy projekte të rëndësishme për qytetarët. Në fshatin Sopijë keni planifikuar 682.405€ për investime në fusha sportive në Sopijë dhe Komunë. Mendoj që është një gabim teknik për këtë kolonë për shkak se investimet në këtë planifikim buxhetor për KAB 2024-2026 sipas këtij projekcioni që e keni përpiluar rezultojnë se vlera është 200.000€ dhe jo 682.405€ e ndoshta na pasqyrohet edhe në rezultatin final. Ajo që nuk shkon është se është një moskoordinim mes drejtorive. Investimi i lartpërmendur është investim që planifikohet nga Drejtoria e Shërbimeve Publike e po ashtu Drejtoria e Arsimit ka planifikuar në këtë projektion buxhetor 250.000€ për ndërtimin e sallës sportive në Sopijë. A mund të jepni sqarime? Për shkollën në Maqitevë i keni planifikuar 345.000€ për ndërtimin e aneksit të shkollës "Besim Ndreca" në Maqitevë. Ju lutem, na sqaroni se çka keni me ndërtu në atë aneks? A ka klasë të mjaftueshme në atë shkollë dhe a ekziston projekt për këtë aneks? Me këtë rënie drastike të numrit të nxënësve shumë shpejt kemi me u detyru që nxënësat me i transportu me një shkollë tjetër të afërt e ju po planifikoni aneks të shkollës. Tek vazhdimi i rrugës "Faik Maliqaj" në Dubravë kërkoj nga drejtori të na sqaroj se ku do të vazhdoj kjo rrugë, për sa metra ka me vazhdu dhe ku ka muhal? A keni projekt për impiantet për pastrimin e ujërave të zeza? A keni lokacion të ndarë dhe a i keni parapa në planifikime hapsinore? Ju nuk keni nda asnjë euro për projektimin e impianteve. Para se me planifikuar buxhet për ndërtimin e tyre, është një numër i madh i procedurave. Ndërtimi i impianteve ka qenë në programin qeverisës tonë e ju po provoni me kopju por as me kopju nuk po dini. Sa i përket projektimit, ju nuk keni planifikuar fare projektim për investime. A doni ta shpenzoni prap buxhetin me metodën e juaj të përafërt e me paramasa shabllon? Bëni punët siq duhet dhe mos keni frikë nga projektimi dhe planifikimi sepse projektimi dhe planifikimi e nxjerr mirë Komunën dhe më serioz, edhe zyrtarët e Komunës i liron nga presioni që po ushtrohet ndaj tyre me pranë dhe me nënshkruar çka është e çka nuk është. Tek investimet në Breshancë e keni një projekt për ndërtimin e Mullirit të vjetër. Ndoshta është një lëshim teknik se nuk mund të ndërtohet Mulliri i vjetër. Sigurisht kemi të bëjmë me ri ndërtim, sivilizim të Mullirit të vjetër. Me çfarë arsytimi e keni kategorizuar si investim kapital këtë investim? Kërkoj nga Drejtoria e Kulturës që ta vizitojë Mullirin e Loshit në Vraniq e të planifikojë mjete që ta rregulloj parterin dhe hapësirat për rreth mullirit. I keni planifikuar 120.000€ për ndërtimin e shtëpive malore mikëpritëse për akomodimin e turistëve. Ku do të ndërtohen këto shtëpi malore? Kush do ti mirëmbaj? Si do të funksionojnë dhe me çfarë kriteri kanë me qenë në shfrytëzim të turistëve? Keni planifikuar 600.000€ në instalimin dhe sanimin e ndriçimeve publike në qytet dhe fshatra. A ka Komuna jonë ndonjë marrëveshje me ndonjë kompani apo organizatë për zëvendësimin e trupave ndriçues eficient dhe shpërndarjen e rrjetit? Nëse po, çka përmban ajo marrëveshje dhe cilat janë detyrimet tona ndaj tyre? Ky projektion buxhetor as për detyrë shkollore nuk i plotëson kriteret.

Reshat Selimaj - Urim, unë e di që je i ri në Asamble këtë mandate. Bëji dy dhe ke të drejtë me kritiku. Për 13 vjet, planifikimet e juaja që keni planifikuar, iu kanë dhënë votën qytetarët dhe e keni pa si e keni pësuar. Votoje nëse don me i ruajt këto vota, përndryshe edhe këto ke me i hup. Në mandatin tuaj, sa qerdhe publike i keni ndërtu ose planifikuar? Sa parqe e palestra sportive? Unë kam qenë dy mandate anëtar i komisionit për emërtimin e rrugëve, parqeve dhe shesheve. Ka 6 vjet që nuk është funksional dhe kërkoj të formohet ky komision për arsye se ka 6 vjet që nuk ka rrugë të reja dhe detyrimisht ke me bë ose aneks ose me përsërit emrin, përndryshe nuk ke ku i qon planifikimet.

Urim Suka - fatkeqësia e parë është se, sa herë e marrin fjalën asambleistat e AAK-së, i drejtohen kritikave të opozitës. Të lus, ta lexosh dokumentin dhe nëse ato që i kam thënë nuk janë ashtu, unë e

miratoj.Kur ne kemi planifiku buxhet,buxheti ka qenë më i vogël dhe atëherë kanë qenë të pa shtruara rrugët më të mëdhaja.Kur i kemi kry ne këto degëzimet e mëdhaja,juve iu kanë mbet disa rrugica dhe ato rrugica për një muaj apo dy po prishen.As nuk keni kualitet,as planifikim dhe as nuk keni përgjegjësi në vendimet që merrni.Palestrën “13 Qershori” ne e kemi ndërtu.

Qëndrim Elshani - i përgëzoj të gjithë akterët që kanë qu deri te sjellja e dy kamerave sepse kjo po e rrit transparencën dhe interesimin.Mirëpo,unë kërkoj që seancat të transmetohen live në facebook.Sa i përket kësaj pike po shihet se dëgjimet publike po mbahen vetëm sa për me e përmbush obligimin ligjor dhe jo për me i ndëgju kërkesat e qytetarëve.KAB 2024-2026 po vërehet se u bë me një ambient ku është Kryetari bashkë me disa nga bashkëpartiakët e tij dhe nuk po merren parasysh kërkesat e qytetarëve. Buxheti për projektet kapitale nuk po ndahte në proporcion me numrin e banorëve të një lokaliteti por po ndahet në proporcion me numrin e votave që i ka marr Kryetari i tanishëm në atë lokalitet.Kjo praktikë po vazhdon qysh prej fillimit të mandatit Muharremaj 2 dhe kjo po vërehet edhe te konkurset e punës dhe te lejet e ndërtimit.Leni njerëzit të punojnë sepse përndryshe është e jashtëligjshme.KAB në formën si ka ardhë në Kuvend është e pa pranueshme,andaj vota jonë është kundër për këtë pikë.

Alban Berisha - desha ta replikoj Reshatin.Edhe unë kam pas shumë vërejtje por në atë kohë kur i kam pas vërejtjet e mia,qysh e di,Reshati me shumë shokë u kanë LDK.Është e vërtetë që tash punohet më shumë se atëherë por është e vërtetë që tash ka buxhet shumë më të madh se atëherë dhe probleme më të vogla se atëherë.Me një buxhet si u kanë atëherë janë bë disa punë të mëdhaja.Sot,me një buxhet shumë të madh bëhen disa punë të vogla por që bien në sy.Mendoj që është duke u punu sepse për atë punë jeni dhe e keni marrë besimin e qytetarëve.Ato qka kanë ndodhë,kanë ndodhë,por atë kohë kur ka ndodhë, jeni kanë edhe ju pjesë e jona.Kryetari po thotë që nuk kqyrim dallime partiake sepse kemi drejtorja e nënpunësa të LDK-së andaj do të thotë që ne gjithmonë jemi pjesë edhe atyre të mirave që i bëni.

Reshat Selimaj - sikur të ish shpreh kështu Urimi sinqerisht nuk e kisha marrë fjalën por ky gjithëçka zi e sikur engjull tu u sjell.Unë të kërkoj ndjesë me që i pranove gjanat.

Laureta Tafaj - Reshati po i përmend engjujt por edhe ky është njëfarë engjulli që sillet nëpër fshtin tonë Gjithmonë mendojsha që e kemi rolin e njejtë,asambleist të dy por kur vike puna te buxheti,gjithmonë u shtrojshin ato rrugë që kërkojke veq Reshati,edhe po vazhdon.

Kryetari - faleminderit për kritikën.Kjo është korniza e parë dhe qarkorja e dytë vjen në gusht dhe është shumë më e saktë dhe në fund të shtatorit është buxheti.Dëgjimet publike janë shpall,janë ,mbajtë në aspektin ligjor dhe kush ka dasht me marrë pjesë,ka marrë pjesë.Kërkesat që kanë hy,95 % janë të kryetarëve të fshatrave.Buxhetin jemi mundu me nda në bazë të numrit të banorëve.Dëshira më e madhe është krejt me i kry.I përmendi varrezat e qytetit por ju e dini problemin e varrezave në qytet dhe unë e di që ka edhe nëpër fshatra problem.Është punu një projekt dhe ai projekt kushton afërsisht 5 milion euro.Ne jemi duke shku fazë-fazë.U përmend edhe Kolektori dhe këtë vit janë të parapara 500.000€.Paret e vitit të kaluar kthehen. Sipas teje Urim,a ka qenë më mirë me shku suficit 500.000€? Kemi kry kontrata dy vjeqare që sot kanë shku në palestra sportive dhe unë e kam marrë këtë vendim.Përgjegjësia bie mbi mua. Kolektori është shpall dhe e ka marrë në mënyrë zyrtare kompania “Famis”dhe do ti presim ankesat 10 ditë.Vitin e kaluar janë kry 4 km kanalizim në fshatin Bllacë,është kry një kullë e dëshmorëve,një shetitore.Për ujë është bë marrëveshja me Hidro Regjionin.Komuna nuk shpall tender për ujë por është kompania shtetërore me të cilën bashkëpunojmë.Në Maqitevë do të ndërtohet shkollë e re.Më së shumti nxënësia kemi në Maqitevë dhe nuk po bie numri,janë 80 nxënës.Selman,në marrëveshjen me Kryesinë e fshatit Vraniq,disa herë kemi thënë që t’ja dorëzoni ujin kompanisë shtetërore Hidro Regjionit siç i kanë dorëzuar shumë fshatra tjerë sepse është problematikë me mbajtë mbikqyrje një fshat ujin si është fshati Vraniq.Te varrezat,shumë fshatra kanë nevojë me i rrethu varrezat mirëpo e keni një vendim të Asamblesë.Gjeje një shoqatë jo qeveritare,mblidhi gjysën e pareve dhe unë të ndihmoj me gjysmën tjetër në aspektin ligjor.Vitin e kaluar e kemi rregullu rrugën për te varrezat në Bllacë.E di që ka shumë varreza në Bllacë mirëpo nuk mundemi krejt varrezat mbrenda një viti ti rrethojmë.Impiantet në fshatin Dubravë rregullohen në bashkëpunim me Hidro Regjionin.Asnjëherë nuk ka pas mjete më shumë.Mjetet po rriten çdo vit duke llogaritur fondin e qeverisë por edhe të hyrat vetanake.

Selman Kolgeci - dua të njoftoj Kryetarin se nuk po flas vetëm për fshatin Vraniq. Ne nuk mundemi me shku dhe njerzit tonë me i varros në therra. Jemi duke kërku me i hek shkurret dhe me bo rrethojën e parcellës. Tek çështja e dhënies në shfrytëzim të ujit, Hidro Regjionit, është në vullnetin e qytetarëve dhe ne nuk mund të vendosim. Sa i përket asaj që për deri sa menaxhohet uji nga një njeri shumë i respektuar në fshat, du me ti kujtu që edhe këto tjerat që menaxhon Hidro Rexhioni s'ka asgjë. A ke ujë në rrugën Xhavit Sylja? Sa i përket ndriçimit publik, unë e bëra një pyetje por nuk mora përgjigje.

Urim Suka kërkon fjalën për një replikë por Kryesuesi nuk e lejon sepse është bërë një here replikë nga Urimi për këtë pikë dhe sipas rregullores nuk lejohet.

Shefket Kolgeci - nuk ka nevojë me kriju tense për një dalje të shefit të grupit parlamentar. Unë mund ta tërheq fjalimin tim dhe me ja dhënë Urimin. Unë jam prej pas lufte në Asamble dhe jam i vetëdijshëm që të gjitha buxhetet i kemi votu, s'i kemi votu, na ka pëlqy apo jo. Ne e dim që mazhoranca i ka numrat. Edhe kur kemi qenë ne në pushtet, gjithmonë ka pas këso replika por në fund ky buxhet është për qytetarët e Komunës tonë. Prandaj ju lus që demokracia të mbizotërojë dhe t'i jepet mundësia që ta shpreh njeriu mendimin e vet. Kryetar, unë e di që participimet kanë mbaru dhe nuk ka më fshati me gjet participim. Është obligim i juaji dhe kemi pas marrëveshje gojore pak pa përfundu mandatin e parë që Komuna të gjej parcellën për varreza dhe të krijojë kushte për ti varros njerzit në atë vend. Gjej një parcellë tjetër sepse ne po kërkojmë zgjidhje për varreza dhe zgjidhja është kjo të cilën Asambleja e ka votu me asnjë vote kundër.

Liridon Fandaj - Kryetar, the që s'du me ndodh si ka ndodh në Peqan për punë të ujësjellësit. Ne e kemi pas një takim dhe jemi marrë vesh edhe si kryesi e fshatit që me vazhdu projektin Hidro Regjioni. Hidro Regjioni dy here i ka marrë nga 40.000€ dhe nuk e ka krye asnjë obligim. Nuk janë fajtor qytetarët që ne ia besojmë Hidro regjionit dhe nuk i kërkojmë përgjegjësi. Korniza buxhetore, nëse duhet të merret parasysh se çka thotë kryetari i fshatit, s'po besoj që Kryetari i fshatit Peqan i ka pru këto dy rrugë për deri sa Drejtori i Pronës ka qenë në dëgjim publik, kam qenë edhe unë. Kanë qenë pesë kërkesa dhe asnjëra prej tyre nuk është në këtë kornizë. Rruga "Lulëkuqja" është tenderu me 25.05.2022 dhe prap është në këtë kornizë. Nëse dëgjimet publike mbahen vetëm për të inicju obligimin ligjor atëherë vazhdoni kështu por është mirë të merren edhe kërkesat e qytetarëve.

Kryetari - te rruga "Lulëkuqja" nuk na kanë lënë sepse ka probleme pronësore. Ato mjete kanë shku në fshatin Peqan dhe ne e kemi fut edhe për vitin e ardhshëm dhe në qoftëse gjejmë gjuhë të përbashkët do ta kryejmë.

Urim Suka - nuk kam asgjë personale me asnjërin prej jush. Është gabim ky planifikim. Kryetari dha disa specifikime dhe një prej tyre tha: kjo është korniza e parë dhe vjen qarkorja e dytë. Unë jam duke e analizu atë që e keni sjell sot dhe kur ta sillni të dytën, flas për atë të dytën. Tha që 95% janë kërkesa të kryetarëve të fshatrave por unë e di që ka edhe ndërhyrje dhe ti përmenda. Në Budakovë dhe Luzhnicë i ke rrugët e shtrune dhe i ke prap në planifikim për vitet e ardhshme dhe ka raste plot. Unë po them ta përmirësojmë dhe ta bëjmë një dokument më të mirë. E përmendi Kryetari Greiqecin. Tri kontrata janë bërë për tri vite dhe asgjë nuk u shtru dhe tash në këtë kornizë është rruga "Dy Martirët" por ajo është rrugë te lagjja Boka. Buxheti që ka planifiku nuk është as për rrugët e lagjes Boka. Përmendi varrezat dhe tha 5 milion është buxheti. A kemi ne kapacitet si Komunë me i shpenzu 5 milion për varrezat e qytetit? Edhe 1.2 milion është gabim. Unë po kërkoj për Bllacë buxhet simbolik dhe nuk përgjigjet, pastaj kërkesat i ka edhe në Vraniq dhe s'ka asgjë. Kolektori është planifikim gabim. Shkolla në Maqitevë, këtu po thotë aneks dhe Kryetari po thotë shkollë e re. Përmendi varrezat në Bllacë, i ka pru dy kamiona zallë por s'ka bërë asgjë dhe ne po kërkojmë zgjidhje.

Lirim Qatani - unë desha të sqaroj për fshatin Duhël. Është një emërtim i rrugës "Hivzi Sylejmani", largohet dhe është fjala për rrugën "Tajar Hatipi" dhe aty mungon edhe një propozim, rruga "Ramiz Qatani". Ndërsa për Greiqec, për këtë vit janë të planifikuara tri rrugë: "Hajriz Xhema, 8 Vëllezët dhe Seferët" dhe aq më mirë që kryesia e këtij fshati e ka parapë që rruga Seferët të vazhdohet edhe vitin e ardhshëm dhe besoj që do të realizohen.

Vullnet Luzhnica - kam një replikë me Urimin sa i përket rrugës "Afrim Buqa" që po i referohet në Luzhnicë. E para është segmenti "Tahir Sinani" e cila është mbi 300 m dhe rruga "Afrim Buqa" është mbi

300 m. Flasi për një buxhet të palnifikun mbi 600 m dhe që nëse i fusim segmentet e rrugicave, del 800 m dhe nuk mjafton ai buxhet. Nuk ka keqplanifikim aty por ka një planifikim të mirëfilltë dhe të specifikum. Unë e di që ke qenë në Luzhnicë dhe të ftoj me pa edhe një herë. Është mirë që kur të vje në Luzhnicë, mi marrë njerëzit e Luzhnicës dhe jo të Javorit sepse e din më saktë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

**17 për, 11 kundër,
Miratohet pika 2**

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përcaktimin e vlerës së bonos banimit;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin

Shefket Kolgeci - sa mjete janë të ndara për këtë kategori? Unë propozoj edhe si asambleist por edhe si grup parlamentar që ky bonus ka nevojë edhe me u shtu. Ne jemi të mendimit që të shkoj në 50% dhe të shtohet numri i anëtarëve të familjeve që i plotësojnë kushtet për këtë bonus dhe nëse keni mjete është mirë të shtohen, gjithmonë brenda mundësive.

Besa Kuçi - nuk ka buxhet fiks të ndan. Është një buxhet prej kategorisë mallra dhe shërbime. Sipas vendimit të Asamblesë janë 7 familje apo 7 persona që përfitojnë nga ky vendim. Kjo shkon përmes kontratave për qiradhënie që i bëjnë personat e përzgjedhur dhe ne e paguajmë 40% të asaj kontrate ndërsa pjesën tjetër të vlerës e paguan personi. Është e juaja nëse doni me shtu numrin e familjeve dhe përqindjen.

Shefket Kolgeci - unë po e them brenda kushteve dhe mundësive me qenë 10 familje dhe vlera e bonusit të jetë 50%.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3 ku përfitues të jenë 10 familje dhe vlera e bonusit të jetë 50%.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e Rregullores 01-Nr-209;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - në seancën e kaluar kemi fol për faljen e borgjeve dhe ne e kemi marrë një vendim atëherë për pjesën e faljes së borgjeve dhe atëherë nuk ka ardhë rregullorja me shfuqizim, e që i bie: prej atëherë dhe deri tash janë kriju disa borgje të reja për deri sa kjo rregullore nuk është shfuqizim. Kjo i bie që për shkak të punës jo të mirë që e ka bërë drejtoria përkatëse dhe qeverisja në përgjithësi, i kemi disa borgje që janë kriju. Me qenë ju më të përgjegjshëm, kur e keni prurë ju këtë rregullore me shfuqizim është dashtë në këtë mbledhje mu miratu një rregullore tjetër. Për deri sa ne nuk e kemi një rregullore sot për me miratu, është gabim këtë rregullore me shfuqizim. Ne sot nuk duhet ta shfuqizojmë këtë rregullore por ta formojmë një komision dhe paralelisht me këtë, kur të vje rregullorja e re, këtë e shfuqizojmë dhe tjetrën e miratojmë. Mënyra si po funksionon është gabim. Ngoni, se nuk e kemi veq për opozitë por për me nxjerr vendime të përbashkëta dhe të mira.

Qëndrim Elshani - si mund të shfuqizohet kjo rregullore pa pas një rregullore të re e cila përcakton funksionalizimin e shfrytëzimit të palestrës? Nëse ne e shfuqizojmë sot këtë rregullore, me çfarë rregullore do të punojë palestra nesër? Në Asamblesën e kaluar është sjell një projekt-vendim për faljen e borgjeve të klubeve sportive të cilat e kanë shfrytëzuar palestrën"13 Qershori". Nëse qëllimi i shfuqizimit të kësaj rregullore është për me heq pagesën atëherë do të mund të mirrej një vendim për me shfuqizim nënin ku rregullohet pagesa e shfrytëzimit të palestrës dhe jo të shfuqizohet rregullorja në tërësi pa u bërë një rregullore e re. Për deri sa nuk i kemi këto përgjigje, ne si grup i LVV-së jemi kundër shfuqizimit deri sa të na sjellni një rregullore të re.

Flamur Bytyçi - na tregoni arsyen se pse po shfuqizoni këtë rregullore sepse nuk po mund ta kuptoj.

Shefket Kolgeci - edhe unë pajtohem me parafolësit. Nëse nuk përgaditet një rregullore e re, nuk kisha thënë me e shfuqizim. Ndoshta zyrtari ligjor e din më mirë se a ka probleme. Ne mbledhjen e kaluar e kemi

kërku listen e borgjlinjëve dhe nuk e keni dorëzuar. Ne nuk jemi për mos mi fal por nuk po dimë kujt po i falim dhe kujt s'po i falim.

Lorika Gashi - i kërkoj falje doktorrit por kam menduar që me sqarimin që e kam bërë e kam pëmbryll me listë. Nuk e kam pas të qartë kërkesën por gjithësesi listen do ta dorëzoj. Rregulloren po e shfuqizojmë sepse është e vitit 2005. Është e një kohe ku ka funksionu UNMIK-u dhe nuk është në përputhje me kushtetutën e Kosovës. Ne momentalisht e kemi një rregullore aktive që është për tarif-ngarkesa, ku edhe pagesat e rregullores përfshihen në atë rregullore e cila është në plotësim-ndryshim momentalisht por është aktive momentalisht. Është sezona e verës dhe shumica e klubeve dhe atyre që e shfrytëzojnë palestrën janë në pushim. Është në shfrytëzim minimal andaj ne e kemi gjet një moment të tillë. Gjithësesi ne kemi kërku prej klubeve kërkesa të veqanta për shfrytëzim momental të palestrës.

Urim Suka - Drejtoreshë, tu kisha lutur që për rastet konkrete të thoni: po, kemi gabuar dhe do të provojmë me plotësi sepse del ma serioz, edhe ne edhe ju. Ne po kritikojmë por ka edhe plot propozime që i miratojmë. Kjo që unë thashë është pa përgjegjësi e juaja. Një klub, nëse ka shkuar, ka krijuar borgj të ri.

Lorika Gashi - me kërkesë, unë ja kam lejuar shfrytëzimin e palestrës pa pagesë.

Urim Suka - nëse ja ke lejuar, e ke shkelur rregulloren. Kur e ke prurë me fal borgje, është dasht me prurë me plotësim-ndryshim rregulloren, mi në tarifata dhe me bërë zero. Kur e ke prurë me shfuqizim këtë është dasht me prurë tjetrën me miratim dhe nuk kishte krijuar hendek.

Qëndrim Elshani - a është qëllimi i shfrytëzimit të kësaj rregullore shkak për me hequr pagesën? Nëse është kështu, pse nuk po e shfuqizoni një nen i cili e rregullon pagesën dhe me mbajtë rregulloren qysh ka me punë palestra.

Lorika Gashi - jo, nuk ka të bëjë vetëm çështja e pagesës. Shfrytëzimi i palestrës ka shumë pika dhe shumë çështje të cilat duhet miratim rregullor. Thashë që ka pas mangësi rregullorja paraprake dhe kemi vendosur me e shfuqizuar në tërësi se sa me ndryshuar secilin nen dhe secilin pikë.

Flamur Bytyçi - nuk e mora përgjigjen dhe më intereson të dija se ku ke mu bazuar? Në ato çmimore që the për tarifa, nuk po kuptoj se ku bazohesh. Duhet ta kesh një argument.

Avni Bytyçi - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë: realisht jeni duke e shfuqizuar një akt i cili nuk ka gjetur zbatim asnjëherë në palestrën sportive. Ku bazohemi për çështjen e caktimit të tarif ngarkesave? Kanë qenë dy rregullore që e kanë rregulluar çështjen e tarif-ngarkesave për çështjen e shfrytëzimit të palestrës sportive. Ka qenë kjo rregullore për palestrën sportive si dhe njëkohësisht është rregullorja për tarif-ngarkesa e cila është e miratuar në vitin 2015 mirëpo implementimi ka filluar të zbatohet në janar të vitit 2016 dhe ajo rregullore është në fuqi. Nëse paraqitet nevoja dhe nëse duhet patjetër që të caktojmë një tarif, Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport e ka bazën ligjore të rregullorja për tarif-ngarkesa për të përcaktuar çmimore.

Alban Berisha - u tha prej zyrtarit ligjor që kjo rregullore nuk ka gjetur zbatim. Unë mendoj që nuk është zbatuar dhe jo nuk ka gjetur zbatim. Është shumë shqetësuese pse nuk është zbatuar rregullorja. Më mirë është një ligj i mangët ose i keq se hiq. Është pyetja për vakumin dhe normal që lejohet, nuk është shkelje e rëndë por pse nuk është zbatuar? Më mirë kish qenë me prurë atë dhe të njejtën kohë ajo e shfuqizon këtë. Nuk ka të bëjë vetëm me tarifa por janë edhe shumë gjëra tjera dhe ato gjërat tjera si keni me i rregulluar?

Avni Bytyçi - plotësisht ke të drejtë mirëpo kjo rregullore nuk e rregullon çështjen e përcaktimit të orarit. Është kompetencë e Drejtorisë së Kulturës për të përcaktuar orarin e shfrytëzimit të palestrës sportive kur klubet sportive bëjnë kërkesë për ta shfrytëzuar.

Alban Berisha - ju kisha lutur që për këso lloj vendime, që secili prej udhëheqësve, drejtorave, që vendimet që i bini në Asamble, secili vendim të ketë edhe arsyetimin.

Shefket Kolgeci - kompetencë e kujt është të formohet ajo rregullore? A është e Asamblesë apo e ekzekutivit?

Avni Bytyçi - rregulloren e nxjerr vetë Qeveria e Republikës së Kosovës me nr.02.2021 e cila përcakton procedurat e hartimit të akteve normative për Kuvendin e Komunës. Është e përcaktuar edhe kush ka të drejtë të propozojë akte normative në Kuvend. Nuk prejashtohet mundësia që propozimet të vijnë edhe nga anëtarët e Kuvendit, nga Ekzekutivi, nga drejtorët, nga shoqëria civile, nga komitetet obligative që janë të themeluara. Mirëpo, i jep kompetencë dhe mandat Kryetarit të Komunës që të formojë komision apo grup punues. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

17 për, 12 kundër
Miratohet pika 4

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Ekonomike” në Duhël;

Flamur Bytyqi - për pikën 5 dhe 6 vlen e njehta për shkak se kthehen për të njejtën arsye për plotësim-ndryshim. Përpos paditurisë të kësaj qeverisje lokale është dëshmuar që e ka n’lidhje edhe mungesën e ekspertizës për planifikime hapsinore. Kjo qeverisje gjithëashtu shpërfaq edhe kokëfortësinë në lidhje me qëndrimet e tyre në raport me rekomandimet që i ka marrë nga zyrtarët e MAPL-së dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor. Rekomandimet që i keni marrë nga zyrtarët e ministrisë sikurse edhe vërejtjet tona që i kemi dhënë, kur ky vendim ka ardhë dy here në Kuvend, ju është dasht ti trajtoni e ti zbatoni me kujdes. Por ju një gjë të tillë nuk e keni bërë dhe keni vazhdu me idenë se ju po dini e mandej detyroheni që një vendim ta sillni nga tre-katër herë në Kuvend. Shpresoj që shpejt keni me u bind edhe ju që nuk dini. Edhe sa here do të kthehet kjo procedurë për plotësim për këto dy vendime? Ku është projekt-propozimi? Ku është shqyrtimi publik? Ku është procedura e miratimit? Ku është fillimi i zbatimit? Ju shkoj mandati dhe ju as një letër nuk po mundeni me përfundu, një plan të hollësishëm të rregullores dhe ju normalisht vlen të iu theksohet që ky është dhe duhet të jetë mandati juaj i fundit.

Qëndrim Elshani - për pikën 5 dhe 6 vlen e njehta. Ne si këshilltar komunal vazhdimisht po iu propozojmë që projekt-vendimet mos me i dërgu në Ministri pa i analizu mirë. Është hera e tretë që këto projekt-vendime sillen në Kuvend për votim. Kjo tregon mos seriozitetin e juaj karshi vendimeve tuaja që i sjellni në Kuvend e të cilat nuk kalojnë ligjshmërinë në Ministrinë përkatëse.

Selman Kolgeci - a mundemi me shku sivjet në pushime pa bregën që ka me u kthi prap ky plan i hollësishëm?

Kryesuesi - besoj që po.

Selman Kolgeci - ne kemi me mbështet prap sikurse e kemi mbështet edhe dy herave të kaluara edhe pse kemi pas vërejtjet tona.

Visar Kuçi - është fakt që ne kur e kemi prurë këtë vendim kemi bashkëpunu me një Komunë që është pajis me këtë dokument dhe kemi shku në formë të njejtë. E kemi dërgu dokumentin dhe na është kthi për plotësim-ndryshim ku thuhet: sipërfaqet nuk kanë nevojë të jenë. Caktoni parcelat kadastrale. I kemi vendos parcelat kadastrale dhe i kemi dërgu në Asamble. Kanë shku në Ministri të Ambientit dhe është kthi prap. Tash thotë: Vendosni edhe sipërfaqet sipas HZK-së. Tash ne i kemi marrë dhe i kemi vendos sipërfaqet kadastrale, sipërfaqet e HZK-së, ia kemi bërë përshkrimin e parcelës. Drejtori tutje jep sqarime.

Flamur Bytyqi - kur keni apliku, a keni kërku prej Ministrisë një listë të dokumentave të cilat duhet me i dorëzë ju për me kry procedurën si duhet?

Visar Kuçi - ne punojmë me ligj të ndërtimit dhe me udhëzime administrative. Besoni që Komunën e Drenasit, si kemi vepru ne, e kanë pais me dokument. Është shqetësuese për mua dhe për zyrtarët e mi se pse janë përdor standarte të dyfishta.

Urim Suka - krejt kjo që është tu ndodh duhet me u bazu në ligj. Para se me bërë këtë projekt-vendim dhe me sjell këtu, duhet me qyrr ligjin dhe të gjitha kërkesat që qyrr ligji, mi fut në projekt-vendim, me i sjell dhe ne me i miratu. Në qoftëse ministria e kthen, s’ke nevojë me sjell këtu por përballu se pse ta ka kthi, sepse ti e ke zbatu ligjin. Mos e merr model Komunën e Drenasit por merr model ligjin.

Visar Kuçi - nëse ka nevojë do ta sjell edhe pesë herë sepse nuk varet nga unë.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

24 për, 1 apstenim
Miratohet pika 5

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për iniciimin e procedurave për hartimin e Planit Rregullues të Hollësishëm për “Zonën Industriale” në Shirokë;

Kryesuesi - pasi kjo pikë është e njëjtë me pikën 5 dhe nuk ka debat,unë e hedh në votim pikën 6.

24 për, 1 apstenim
Miratohet pika 6

Pika 7. Pyetje dhe përgjigje;

Selman Kolgeci - Pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike:një pjesë e madhe e trupave ndriçues në Vraniq janë jasht funksionit.A keni me ndërmarr ndonjë hap me i rregullu dhe a është duke e përcjell dikush garancionin e punimeve?Pyetje për Drejtorin e Bujqësisë:gjatë bisedave me disa qytetarë,jam njoftu me vështirësitë që ata kanë për ti punuar tokat e tyre si pasojë e gjendjes shumë të keqe e gati të pakalueshme të rrugëve fushore dhe mungesës së investimeve në rrugë fushore në Muhlan edhe pse qytetarët pohuan që disa herë kanë paraqit kërkesë për një investim të tillë.Ju lus ta keni parasysh këtë.Në Gelancë me muaj të tërë është një pusët e hapur ku i mungon një kapak dhe besoj është një investim i vogël.Kryetar,dua ta di,rruga te unaza ku ka me m'rri?A ka naj cak?A ka shpenzime?A ka pengesa?Pyetje për Drejtorin e Urbanizimit: a keni lëshu kushte dhe leje ndërtimore me HZK?A ka banesa në trajtimin e lëndëve për leje dhe kushte ndërtimore ?A janë të njoftuar zyrtarët komunal detaisht se çka përmban plani dhe cilat janë obligimet që dalin nga ky plan?A keni zyrtar të mjaftueshëm për t'iu përgjigjur palëve?A ka vështirësi tjera në zbatim të këtij plani?Dua të di për HZK-në vështirësitë,problemet në naturën se si po zbatohen vonesat eventuale të trajtimit të kërkesave.

Kryetari - puseta në Gelancë,a është e ujit apo e kanalizimit?Te KEK-u dhe te Hidro Regjioni kemi probleme shumë të mëdhaja.Deri sa paguan taksën e ujit dhe paguan për kanalizim çdo muaj dhe në Suharekë me siguri paguajnë mbi 10.000 familje dhe nga 1€ me qenë muaji,në vit i bie 120.000€.Kanë pas mundësi mi ble 2 makineri dhe ku ka nevojë,me shku me pastru kanalizimin.Me unazën kemi pas problem gjatë pandemisë dhe kemi pas problem me ngritjen e çmimeve.Momentalisht i kemi dy probleme pronësore juridike.Kryetari jep sqarime se i përket këtyre problemeve.Si të kalojnë këto dy probleme, ruga del në rrugë të Reqanit dhe del në Biraq.Probleme kemi sepse kjo rrugë është 5 km dhe 5 km me qel rrugë private nuk është e lehtë.Dëshira e madhe është që të kryhet kjo rrugë sepse do të shliroj qytetin shumë.

Enver Shabani - ne kemi një kontratë të hapur dhe aktive për mirëmbajtjen,sanimin dhe ndërtimin e ndriçimit publik.Secila punë që përfundon ka një vit garancion dhe ne i përcjellim kohë pas kohe.

Ardian Kotorri - është një kërkesë e arsyeshme e fermerëve të fshatit Muhlan.E kam një kërkesë të tyre dhe e kam një kontratë aktive por e kam edhe një kontratë tjetër që pres me inicuu.E them publikisht që do ta trajtojmë si kërkesë dhe do të shkojmë në teren atje.

Visar Kuçi - po,kemi lëshu leje ndërtimore dhe kushte ndërtimore.Janë lëshu leje ndërtimore 25 apo 26 dhe të gjitha janë publike.Ndoshta kemi vështirësi por jo më shumë se me planet hapsinore në të kaluarën.HZK na ka mundësu që ne me lëshu leje në gjithë territorin e Komunës së Suharekës.Nuk kemi zyrtar të mjaftueshëm.Edhe ne si shumë drejtori tjera apo shumë komuna tjera kemi vështirësi njëherë me i punësu por kemi vështirësi edhe që nuk aplikojnë sepse të gjithë e dimë se sa paguhet një ingjiner i ndërtimtarisë apo një arkitekt në privat kurse në institucione shtetërore e kanë pagën e ulët.Në detyrë projektuese, kompania e ka pas edhe trajnimin e zyrtarëve dhe i ka trajtu zyrtarët.Zyrtarët e kanë më të lehtë sepse e kanë programin.

Selman Kolgeci - Kryetar,në Gelancë bëhet fjalë vetëm për një kapak të pusetës dhe kushton 120€.

Kryetari - si ka mundësi,një drejtori në Komunë me shku me ble një pusetë?Nuk e dite a është pusetë e ujit apo e kanalizimit.Nuk kemi mundësi me ble sepse duhet me ble çdo ditë.Ju e dini rastin në Vraniq.

Selman Kolgeci - është kapak i pusetës dhe ne e kemi kontratën aktive të sanimit dhe mirëmbajtjes së rrugës në paramasën e të cilit ekziston ky pozicion.Te shpronësimet përmende disa pengesa.Kur kanë mu

tejkalu këto pengesa? Rruga nga kanali i Dubiqakut deri te ura,mbrapa xhamisë,a është e ndërtuar sipas kritereve dhe normave gjeometrike?

Kryetari - prej lumit te xhamia,atë rrugë e kanë hap qytetarët me dëshirën e vet.Është rrugë e përkohshme.

Selman Kolgeci - z.Shabani,treguat që keni një kontratë aktive por nuk treguat kur keni me fillu me sanu ndriçimin publik në Vraniq.Te çështja e punësimit të inxhinierëve,nuk do të thotë që këta me ardhë me punu me pagën që përcaktohet me ligj.Ju mundeni me prokurim publik të bëni shpallje sikurse e ka bërë Prishtina për 12 inxhiniera që i ka marrë me pagën 700-800-900.

Kryetari - s'kanë të drejtë me nënshkru.E kemi provu dhe për deri sa s'kanë të drejtë atëherë pse me i marrë.

Visar Kuçi - edhe ne kemi punësu përmes procedurës së prokurimit.Ata që pranohen quhen ekspertë.E hartojnë dokumentin,e kompletojnë por nënshkrim nuk i lejohet me vendos.Edhe vet zyrtari,në moment që si lejohet atij nënshkrimi,edhe një here duhet ta trajtojë lëndën.Sa i përket pusëtës në Gelancë,një javë para Viti të Ri e kemi ndërru atë pusëtë dhe në fund të janarit kanë bërë kërkesë sepse e ka vjedh dikush.Është mirë të ndërrohet por ne kemi shumë kërkesa.

Enver Shabani - thashë që kontrata është e hapur dhe ne jemi duke punu në vazhdimsi.I kemi 42 fshatra dhe qytetin andaj nuk po mund të arrijmë që të gjitha ti sanojmë në kohë optimale.

Shefket Kolgeci - kam një kërkesë nga shkolla fillore “Dëshmorët e Kombit” në Vraniq, por edhe e kryesisë së fshatit.Kërkesa është që shkolla të furnizohet me ujë sepse nuk ka ujë shkolla.Ka qenë harmonizimi i kryesisë së fshatit që të merret prej bazenit dhe të vendoset një gyp ekstra i cili ka afërsisht 1.500 m dhe kostoja është 7-8 mijë euro.Kemi kërkesë nga Drejtoria e Arsimit dhe nga Kryetari që kjo kërkesë imediate së paku në shtator të realizohet dhe nxënësat të kenë ujin e tyre.

Urim Suka - pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike:drejtoria juaj,për ndërtimin e rrugës “Dugagjini” “Ymer Krasniqi” segment dhe disa rrugë të tjera në Bllacë ka hartu një kontratë dy vjeqare për vitin 2022.Nga kjo kontratë disa rrugë janë shtrur mirëpo rruga “Dugagjini” dhe rruga “Ymer Krasniqi” seg. nuk janë shtrur fare.Pse nuk janë shtrur këto rrugë për deri sa figurojnë në kontratë dhe kur pritet të shtrohen?Pyetje për Drejtorinë e Shëndetësisë :Në Asamblenë e kaluar unë kam kërkuar sqarim nga Kryetari dhe nga D.Shëndetësisë për mos funksionimin e AMF ve në Bllacë,Semetisht,Nishor,Dobërdelan dhe Leshan.Përgjigja ishte që tani kemi marrë disa mjek dhe pritet shpejt të funksionalizohen këto AMF. Këto ditë unë kam parë një status të Drejtoreshës Besa Kuçi në llogarinë e saj në facebook ku kërkonte nga menaxhmenti i QKMF-së për ti funksionalizuar këto qendra.Për mua është e pa pranueshme komunikimi përmes facebook-ut. Gjithëashtu ka fillu ndërtimi i QMF-së në Duhël për të cilën e përshëndesim dhe stafi atje është bartë në Bllacë.A keni ndërmend me i funksionalizu këto qendra? Kam marrë disa shqetësime nga banorët në Suharekë por edhe nëpër fshatra për pastrimin e varrezave.A ka drejtoria juaj një kontratë të lidhur me Eko Regjionin apo dikënd tjetër për të bërë pastrimin e tyre dhe nëse ka,pse nuk ka ndodh pastrimi i varrezave?

Kryetari - te ajo që ka reagu drejtoresha,kjo është demokraci dhe nuk na pengon.Besoq që tash i kemi edhe laboratorat me i funksionalizu dhe hyn me vendim të përhershëm të gjitha AMF-të.Më vie mire që e ke pa që s'janë pastru varrezat e qytetit.Ju kam thënë që,të kisha qenë Kryetar me menaxhu Eko Regjionin,800€ do tja bëja pagën.Momentalisht e kanë lënë punën shumë punëtor dhe ka probleme shumë të mëdhaja dhe Kryetari s'mund të vendos sepse është një bord dhe bordit nuk i intereson a kryhen punët në Suharekë.Kryetari tutje jep sqarime dhe kërkon që rregullorja të sillet mbledhjen e ardhshme pasi që është duke u e bërë një projekt shumë të mirë Xhajka japoneze dhe na ka ndihmu me shumë kamiona.

Enver Shabani - z. Suka,është e vërtetë që kemi një kontratë dy vjeqare andaj kontrata nuk ka përfunduar por është aktive.Besoq që rrugët duhet të kryhen brenda kësaj kontrate.Sa i përket varrezave,Kryetari ta dha përgjigjen por për veq asaj ka pas mungesë të punëtorëve dhe ka qenë kohë me shi.Kemi kontratë por ka mungesë të punëtorëve.

Kryesuesi - natën e Bajramit edhe mua më kanë thirr.E kam thirr kryeshefin ekzekutiv të Eko Regjionit dhe ai më ka thënë që pesë punëtor e kanë lënë punën dhe se,sa të kemi mundësi me m'rri,ne i qojmë këta edhe nëpër lagje tjera.Në pa mundësi të punëtorëve nuk kanë mujt me i pastru sepse çdo here i kanë pastru.

Urim Suka - nuk është dasht me prit natën e Bajramit për me i pastru ato varreza por keni mujt më herët. Kryetari shumicën e rasteve dha përgjigje tjera, dul te rregullorja që s'ka kalu. Ne të kemi thënë atëherë që atë rregullore, përcaktoje që ka me iu rrit 30 % çmimi qytetarëve dhe 30 shkojnë për punëtor. Përcaktoje në rregullore, bjere dhe e kqyrim a pe votojmë. Te AMF-të unë s'mora përgjigje. A do me i hap apo jo? Po filloni me komuniku në Facebook njëri me tjetrin dhe për mu nuk është praktikë e mirë. Kur jemi te metrat katror, unë për atë fola për kornizën. Kërkun se ki planifikimin, kërkun se ke kornizën, kërkun se ki implementimin e projekteve dhe shkeljet ligjore i ke në secilin vendim. Andaj këto metrat katror s'kam nevoj m'i kqyr sepse ato po shihen në çdo vendbanim.

Besa Kuçi - kur e kemi marrë detyrën, i kemi premtu qytetarëve që do të jemi në shërbim të tyre. Komunikimin se si e bëj unë përmes Facebook-ut, ajo është llogaria ime personale dhe ska çka i pengon askujt. Ne jemi në procedura dhe brenda mundësive ligjore jemi duke vepru. Nga java e ardhshme nisim funksionalizimet e AMF ve. Drejtoresha tutje jep sqarime.

Laureta Tafaj - Kryetar, personalisht po ndihem shumë e ofenduar me fjalën paraprake që e the. Ne nuk kemi bërë asnjëherë politikë me Eko Regjionin dhe është e turpshme me na thënë atë fjalë. Tu kemi lut dhe të kemi thënë që ta sillni një dokument që e vërteton rritjen e pagës së tyre dhe krejt kemi me qen për. Të lutem tërhiqe atë fjalë. Bjere dokumentin dhe e votojmë krejt.

Kryetari - të vetmit janë ata që kanë punu në pandemi. Unë nuk vendosi. Tash kemi me shpall konkurs dhe nën 300€ nuk vje askush.

Laureta Tafaj - a kemi të drejtë ligjore që 1.50€ nëse e votojmë ne, me ja nda punëtorëve të Eko Regjionit në Suharekë në ndonjë formë tjetër, jo përmes pages por si shtesa? Nëse po, atëherë mujna me bo një formë të tillë dhe jo me na akuzu neve që ne nuk kemi dasht me ja rrit rrogën atyre.

Kryetari - paga atyre brenda dy muajve ka me iu rrit, e aprovuam apo jo rregulloren pasi që ka marrë vendim Asambleja e Prizrenit me i rrit, Rahoveci e të gjitha Komunat dhe ata nuk mund të bëjnë dallime.

Reshat Selimaj - i përmendi doktorri dy çështje e që ky është mjeshër me i inicë në mënyrë të qetë dhe tema ishte për varrezat dhe ujësjellësin ndërmjet dy fshatrave. Ju e dini mire që në këtë Asamble e kemi formu një komision, që atij komisioni për dalje në teren i ke pri ti. Ne e kemi dhënë votën komplet pro por na keni qit në lajthitje duke thënë që ne kemi pas debat me dy fshatrat, Popolan dhe Vraniq. Kur kemi shku në teren ka dal ndryshe. Ende jam aktiv në atë komision. Pse nuk ke inicë më takime? Sa i përket komisionit të ujit, edhe këtu na është thënë që: ne fshatrat skemi problem. Kur kemi shku në takime ka dal realiteti ndryshe. Nuk është mire të bëhet politikë me këso gjana.

Shefket Kolgeci - unë i kërkova Drejtorisë së Arsimit dhe Kryetarit me nda mjete shtesë për këtë projekt që të furnizohen nxënësat me ujë. Komision për ujë ka pas ndërsa në komisionin për varreza unë nuk kam qenë nëse ka pas.

Reshat Selimaj - në atë mandat kur e kemi pas ne komisionin, ti ke pas me udhëheq, ne ta kemi dhënë votën. Zoti Kolgeci na ka dëshmu që nuk ka problem fshat me fshat. Kur kemi shku në Vraniq, unë ia kam spjegu saktë. Qytetarët e Vraniqit me të drejtë kanë shqetësimin sepse ata janë investitor në atë ujë.

Laureta Tafaj - ai komision ka qenë shumë i ndjeshëm. E kemi marrë me shumë dëshirë me përfundu atë punë. Na kanë thënë që s'ka problem mes fshatrave mirëpo nuk po gjejmë dot zgjidhje dhe ka dal e kundërta. S'kemi mujt me bërë asgjë sepse banorët e fshatrave kanë qenë shumë të revoltuar njëri me tjetrin. Nuk duhet fajtuar as komisioni, as pushteti sepse aty nuk ka pas mundësi me bërë të përbashkët ujin. Besoj që nuk kemi nevojë me diskutu më atë temë e cila është përmbyll. Reshati ka të drejtë sepse kemi has në vështirësi të mëdhaja, sidomos në Vraniq.

Selman Kolgeci - çmoj punën e komisionit por mendoj që ai problem nuk mund të zgjidhet përmes komisionit. Duhet gjithëpërfshirje e dy fshatrave. Çështjen e varrezave nuk e ngriti doktorri. Sa i përket atij komisioni, cili ka qenë mandati i atij komisioni? Këta, gjeodeta nuk janë. Vetëm i ndani mjetet, i pastroni shkurret, e rrethoni.

Reshat Selimaj - ne unanimisht ia kemi dhënë votën pro. Kemi formu një komision dhe kur kemi shku atje, fshatrat kanë pas problem dhe ka mbet në heshtje.

Selman Kolgeci - falemderoj anëtarët e Kuvendit kur është votu kjo. Nëse ju keni votu një diçka që nuk keni shku me bisedu me qytetarët e as me njerëzit e juaj atje, kjo është për keqardhje. Nuk ka pas asnjë kundërshtim dhe kundërshtimet kanë dal pastaj dhe ti e din mirë kush i ka inicë këto kundërshtime atje.

Liridon Fandaj - kam një pyetje për Drejtorin e Pronës. Deri ku keni shku me mbikqyrjen e kontratave në zonën Industriale dhe a keni një raport të komisionit të mëhershëm? Cilat janë rekomandimet e atij komisioni deri në datën kur ju e keni marrë mandatin si komision?

Armend Krasniqi - ne kemi dal në teren dhe i kemi verifiku 19 kontrata të operatorëve ekonomikë. Jemi duke i marrë të dhënat dhe akoma nuk jemi në një raport përfundimtar. Janë disa raporte të komisioneve të kaluara, Disa raporte i kanë shkëput disa kontrata, qoftë në Z. Industriale dhe qoftë në Agrozonën në Samadraxhë.

Jehona Rrafshi - shqetësim i imi dhe i qytetarëve është në fshatin Duhël. Problemi është me kanalizimin në Biraq e cila vazhdon deri te kompania e derivateve “Bihi petrol”. Ky kanalizim ka fillu të punohet por nuk ka vazhduar dhe si pasojë e mos punimit të këtij kanalizimi ka pas edhe ngordhje të bagëtive. Qytetari e ka shpreh këtë shqetësim te organet kompetente por nuk është ndërmarrë asnjë veprim. Pyetje për drejtorin e Shërbimeve Publike: Kur do të vazhdoj me kanalizim? Pyetje për Drejtorin e Bujqësisë: Çka do të ndërmerret me këtë person për dëmin që i është bërë, me ngordhjen e bagëtisë? Këshilli i fshatit Bllacë i ka sjell disa prioritete. A mund të tregoni se ku jeni bazu që i keni hek disa planifikime? Ato që janë përfshi, ku jeni bazu? Është fjala për rrugën “Valbona” seg. i cili hyn në planifikim disa herë dhe prap është hek nga planifikimi.

Enver Shabani - është e vërtetë. Kompania ka qenë e kontraktuar dhe ne kemi shku në atë vend por nuk është bërë asnjë metër kanalizim sepse kemi pas probleme të atij lloji që s’kemi mund ti vazhdojmë punimet. Në momentin që ata janë të gatshëm dhe që ska probleme pronësore dhe probleme tjera që neve nuk na shkatojnë probleme dhe kompanisë, ne jemi të gatshëm me vazhdu me kanalizim.

Ardian Kotorri - ju e dini mirë që Ministria e Financave nuk lë kod buxhetor financiar për Komuna, për fond emergjent. Unë kam bërë një premtim publik për një rast tjetër dhe kam dhjetra raste të natyrave të ndryshme, që prej subvencioneve do ta gjejmë një formë për ti subvencionu. Edhe këtë rast ne e kemi si kërkesë dhe do ta trajtojmë si problematikat tjera.

Elmaze Bytyqi - kam një kërkesë nga grate pensionere të Komunës së Suharekës. Kanë kërku që nga Komuna ta ndajnë një objekt për qëndrim ditor. Unë e di që është një qëndrim për pensioner por ajo zhvillohet vetëm nga gjinia mashkullore.

Nënkryetarja - bëjeni një kërkesë me shkrim sepse tash përgjigjen nuk mundemi me ta dhënë.

Takimi përfundoi: 12:35

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj